



Prishtinë, 05.09.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1584_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2331_07_22** i dt.14.07.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **04.08.2022**;

në seancën e mbajtur më datë **05.09.2022** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.K nga komuna e Fushë Kosovës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2331_07_22, i datës 14.07.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 14.07.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2331_07_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit A.K dhe e ka obliguar KESCO-n të bëjë korrigjimin në vlerë **-23.07€** duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara në periudhën 02/03/2022.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhën 03/2022 është i saktë dhe i njëjti është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsor.
- Faturimi i gjendjeve të regjistruara në njehsor është bërë sipas tarifave TL=3498 kWh dhe TU=1331 kWh me shpeznim mujor në TL=1139 kWh dhe në TU= 431 kWh.
- ZRrE/DMK vendimin e saj e bazon në periudhën e faturimit, ku leximi paraprak ka qenë me datë 28.01.2022 dhe leximi për periudhën 02/2022 ka qenë me datë 19.02.2022.
- Duke marrë parasysh që pranimi i instalimit elektrik është bërë me datë 28.12.2021, realisht faturimi deri me datën 28.01.2022 ka përfshirë periudhën një mujore. Pra nga data 28.12.2021 deri me datë 28.01.2022 është bërë faturimi për periudhën një mujore.
- Fatura 03/2022 për të cilën konsumatori ka ankesë, çdo korrigjim në këtë rast do të ishte i padrejtë pasi faturimi për periudhën 03/2022 përfshin periudhën një mujore dhe shpërndarja e kWh-ve në cilëndo periudhë nuk do të ishte i saktë.



- Konsumatori nuk e ka konstestuar faturimin për periudhën e kaluar por vetëm faturimin për periudhën 03/2022.
- Faturimi për periudhën 02/2022 ka qenë më i shkurtër se një muaj (në këtë rast 22 ditë) edhe për faktin se ka qenë e imponuar për shkak të ndryshimit të strukturës tarifore me datë 09.02.2022 dhe faturimi për periudhë më gjatë se 30 ditë do ta dëmtonte konsumatorin nëse kalon bllokun e parë tarifor, por asesi nuk e ka dëmtuar në këtë rast ku faturimi përfshin periudhën e shpenzimit më pak se 30 ditë (në këtë rast faturimi prej 22 ditëve – periudha 02/2022 nuk ka arsye të shpërndahet me shpenzimin e periudhës vijuese një mujore 03/2022).
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2331_07_22 i datës 14.07.2022 për konsumatorin A.K.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.09.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi për periudhën 03/2022 është i saktë, ZRrE thekson se, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, si Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 04.04.2022 ; Përgjigja e KESCO-s e datës 08.04.2022; Procesverbali për pranimit të instalimit elektrik nr. 0059275 datë 28.12.2021; Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike dhe listat e leximit periudha 01/2022 deri më 06/2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 21.04.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2331_07_22 i datës 14.07.2022, Kundërshtimi nga KESCO i vendimit të DMK-së i datës 04.08.2022, ka gjetur se ky pretendim nuk qëndron si i tillë, sepse nga të gjitha provat e ofruara më lartë dhe sipas listave të leximit konstatohet se periudha e leximeve të konsumatorit në mes shpenzimeve të faturuara janar (28.01.2022) dhe shkurt 2022 (19.02.2022) është me i shkurtë se cikli mujor i leximeve, ku për periudhën shkurt kemi 22 ditë shpenzime e që është në kundërshtim me Procedurën e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tariforë pasi që me këtë procedure leximi i njehsorëve duhet të përfshijë periudhën një mujore të shpenzimit të energjisë.

Në një vështrim kronologjik të këtij rasti, ZRrE gjen se, fillimisht Departamenti i faturimit në KESCO me datë 24.03.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2022 me **1,570 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **140.05€** . I pakënuqur me datë 04.04.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturës për periudhën mars 2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 20083568. Më tutje me datë 08.04.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe leximet e rregullta mujore. Ndërsa me datë 21.04.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti bëhet ri shqyrtimi i faturës për periudhën mars 2022, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 20083568. Pas analizimit dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave lëndore, ZRrE gjeti se, lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se në asnjë periudhë nuk ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik apo që dyshon se njehsori nuk benë matje të saktë.

ZRrE ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike bazuar në të cilën vëren se periudha e leximeve të konsumatorit në mes shpenzimeve të faturuara Janar (28.01.2022) dhe Shkurt 2022 (19.02.2022) është me i shkurtë se cikli mujor i leximeve, ku për periudhën Shkurt kemi 22 ditë shpenzime e që është



në kundërshtim me Procedurën e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tariforë pasi që me këtë procedurë leximi i njehsorëve duhet të përfshijë periudhën një mujore të shpenzimit të energjisë. Data e leximit të çdo konsumatori do të jetë e njëjtë si e leximit paraprak me maksimum ± 2 (dy) ditë pune. Në rast se data e leximit dhe toleranca e lejuar 2 (dy ditë) i bie të jetë në fund të javës ose gjatë festave shtetërore atëherë periudha kohore e shpenzimit të energjisë elektrike mund të shkurtohet ose të zgjatet për aq sa zgjasin këto festa. DMK duke marr për bazë ditët e shkurtuara në periudhën Shkurt 2022 ka bërë shpërndarjen e kWh të faturuara në periudhën Shkurt dhe Mars 2022 dhe ka konstatuar se konsumatorit duhet ti bëhet korrigjimi në vlerë **-23.07€**. ZRrE konstaton se vendimi i marrë nga DMK është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si i tillë mbetet në fuqi.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme. Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.09.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit A.K. dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar